

British  
School  
of Tirana



WHEN  
I GROW  
UP...



# 10 ARSYE PËR TË ZGJEDHUR BRITISH SCHOOL OF TIRANA

REGJISTRIMET  
KANË FILLUAR

**GODINA E SHKOLLËS**, është e vendosur në një nga zonat më të mira, me ajër të pastër dhe me infrastrukturë të përsosur të Tiranës, brenda Rezidencës Kodra e Diellit 2. Godina e shkollës ofron hapësira rekreative të jashtme me **gjelbërim** dhe sipërfaqe ujore, hapësira mbështetëse të brendshme si dhe hapësira akademike aspak tradicionale ku **laboratorët** ose "resource centers" janë të integruara në çdo klasë për fleksibilitet dhe përdorim maksimal të praktikës në mësim-nxënie.

**TERENET SPORTIVE DHE AKTIVITETI SPORTIV**, përbejnë një pjesë shumë të rëndësishme të funksionimit të British School of Tirana. Përveç sporteve individuale dhe në grup, në British School of Tirana të gjithë nxënësit **mësojnë notin** si pjesë e programit të Edukimit Fizik që zhvillohen në pishinë dimërore.

**DREJTUESIT E SHKOLLËS** Drejtoresha e shkollës, Znj. Deborah Jackson, vjen nga një eksperiencë e gjatë në arsimin fillor në Angli, me 30 vjet në pozicione mësimdhënie dhe drejtuese në shkollat fillore në zonën e Devon në Angli. Debbie ka kryer Master në Edukim dhe Bachelor of Philosophy në Edukim, zotëron statusin e mësuesit të licencuar në UK si dhe është e çertifikuar si Trajnuese e Mësuesve (Teacher Trainer Qualification).

**PROGRAMI MËSIMOR I BRITISH SCHOOL OF TIRANA** është në gjuhën Angleze dhe sipas National Curriculum of England and Wales, programi zyrtar i arsimit në Mbretërinë e Bashkuar. Programi ofron disa **avantazhe a)** zhvillon fëmijën në të gjitha aspektet, jo vetëm nga ato akademike **b)** fokusohet në thellësi mbi çdo koncept dhe subjekt që studiohet përpara së të kalohet në temën pasardhëse **c)** zhvillon aftësi dhe vlera qytetare si dhe aftësitë bazë për shekullin e 21të (mendimin kritik, kreativitetin, aftësitë digjitale, etj).

**STRUKTURA E PROGRAMIT** nuk i kërkon fëmijëve deri në Year Six të kenë set librash për përdorim personal sepse fëmijët përdorin një seri burimesh informimi, tradicionale dhe elektronike, dhe mësuesi shërben si "filter" për materialet që çdo nxënës ka nevojë të përdorë. Detyrat e shtëpisë deri në Year Four kanë të bëjnë vetëm me **leximin e librave** jashtëshkollë nga biblioteka e shkollës. Midis klasës Year Four dhe Year Six detyrat konsistojnë në projekte apo ushtrime javore, kryesisht në Matematikë.

**INSPEKTIMI DHE SIGURIMI I CILËSISË**, British School of Tirana është objekt i inspektimit nga institucionet e ngarkuara prej Ministrisë Britanike të Arsimit (Department for Education and Skills) për inspektimin dhe akreditimin e Shkollave Britanike jashtë vendit (British Schools Overseas).

**EDUKIMI ARTISTIK** sipas kurrikulës britanike, arti përfshin dizanjin dhe teknologjine kurse muzika është lëndë e veçantë. Shkolla ka një **"Music Room"** për praktikimin e instrumentave muzikore dhe mësimet bazë në instrument ju ofrohen brenda programit të gjithë nxënësve.

**ZHVILLIMI KULTUROR**, British School of Tirana ka krijuar partneritet me shkolla fillore në Mbretërinë e Bashkuar për të bashkëpunuar në projektet **ndërkulturore** me nxënësit sidoms në temat si "British values", "Bota që na rrethon", tema specifike në lëndë të Shkencës, Gjuhës Angleze, etj.

**SHKOLLA E PARË STEM** shkolla thekson rëndësinë dhe drejton vëmendjen e fëmijëve që prej Year One drejt STEM (Science, Technology, Engineering and Math) duke u bërë kështu e para shkollë STEM në Shqipëri. Në drejtimin STEM të shkollës përfshihet **"coating"** që prej Year One dhe në përgjithësi "vrojtimi" dhe "të menduarit shkencor" si aftësi të vlefshme për formimin e fëmijës "kurioz për botën që na rrethon".

**SHËRBBIME TË TJERA** British School of Tirana ofron **transport** për nxënësit, **ushqim** të shëndetshëm e të balancuar i cili përgatitet në guzhinën tonë, **klube** jashtë shkollë dhe kujdes me orar të zgjatur **për nxënësijtë tanë** në rast nevojë të prindërve.

